

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE ALUIZNI GJIROKASTËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Gjirokastër**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.09.2013 deri më datë 01.10.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 155, datë 03.12.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1063/13, datë 20.03.2015, i ka rekomanduar z.Artan Lame Drejtor i Përgjithshëm i Aluizn-it, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIM PËR NDRYSHIM LIGJOR:

1. Gjetje nga auditimi. Në auditimet e kryera në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, Gjirokastër dhe Durrës, vërehet një fenomen i përgjithshëm, i cili konsiston në mënyrën e llogaritjes dhe dokumentimit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Kështu, nga auditimet e praktikave të legalizimit në këto subjekte, është konstatuar se në dosjet përkatëse, nuk ishin të plotësuar me vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë (si pjesë e dosjes), siç përcaktohet në nenin 27-*Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin*, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, pika “ç”, ku shprehimisht citohet: “.....vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi”.

Si rezultat i këtij veprimi, në buxhetet e njësive vendore nuk janë arkëtuar të ardhura nga kjo taksë, gjë e cila është dokumentuar nga grupi i auditimit në rakordimet që janë bërë me drejtorinë/zyrat e financave të njësive vendore, Fier, Gjirokastër dhe Durrës. Nga vlerësimi i kryer, ka rezultuar se: ka një numër personash të cilët megjithëse kanë marrë leje legalizimi dhe kanë vijuar procedurat ligjore për regjistrimin e pronës në ZVRPP, nuk vërtetohet me dokumentacion ligjorë kryerja e pagesës së kësaj takse, konkretisht në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Gjirokastër, vlera e pallogaritur dhe pa arkëtuar paraqitet prej **3,584,364 lekë për 142 persona**.

Pra, siç shihet ekzistojnë dy dispozita të cilat janë në mospërputhje njëra me tjetrën, ku njëra është dispozitë ligjore dhe tjetra nënligjore ose normative, pasi pika 5 e VKM nr. 860, datë 10.12.2014, nuk është nxjerrë në zbatim të ligjit të legalizimeve.

1.1. Për këtë rekomandojmë: Mbështetur në pikën “a” të nenit 15, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i kërkojmë Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, **të marrë masa dhe të propozojë pranë Këshillit të Ministrave për:**

-Shfuqizimin e pikës 5, të Vendimit të KM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, ose nxjerrjen e një akti tjetër nënligjorë plotësues për rregullimin e këtij fenomeni.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se megjithëse ka objektet informale të cilat nuk plotësonin kriteret ligjore për legalizim, nga administrata e ALUIZNI-t Gjirokastër, nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për s’kualifikim e tyre, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 e nenit 2 dhe nenin 39-*Përjashtimi nga Legalizimi*, Kapitulli IV, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, urdhrit nr. 291 datë 01.09.2008, urdhrit nr. 846 datë 11.10.2012, si dhe neni 42, VKM nr. 40 datë 11.01.2012 pika 2 dhe pika 3 germa “a”.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të marrë masa që të gjitha objektet informale të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, të ndiqen procedurat për s’kualifikim e tyre.

Brenda datës 30.01.2016

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer për ankesat e bëra nga **Kryegjyshata Botërore Bektashiane Tiranë**, adresuar institucioneve shtetërore, si; Kryeministrisë, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Gjirokastrë, për zaptimin e pronave nga posedues të tjerë, rezultoi se për **9 praktika** nga sektorët e Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Gjirokastrë, nuk janë ndjekur procedurat ligjore, si dhe nuk ka pasur bashkëpunim me institucionet e tjera në lidhje me legalizimet e kryera në pronat e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, të njohur me VKKP nr. 154/5 datë 26.09.1996 (Teqenë e Zallit) dhe VKKP nr. 134, datë 13.03.2008 (Teqenë e Shtufit), veprime këto në kundërshtim me pikën “b” të nenit 4, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10058, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikën e Shqipërisë dhe Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellat”.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë të marrë masa, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat në pronat e Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, të fillojë procedurat për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të ligjit të legalizimit, ndërsa për personat të cilat janë në proces të legalizimi të bashkëpunohet me institucionet përkatëse, për marrjen e informacionit ligjor për vijimin e procedurave të legalizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në **2 praktika**, objektet informale janë legalizuar në prona të Bashkisë Tepelenë, veprime këto në kundërshtim me pikën 1 të nenit 3, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar,

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Njësitë Vendore të Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e pronës të objekteve në proces legalizimi, duke marrë informacion nga Njësitë Vendore mbi pronat e zaptuar dhe Planet Zhvillimore që mund të prekin këto prona, pavarësisht nëse ato janë ose jo të regjistruara në ZVRPP.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në **20 praktika**, objektet informale janë legalizuar në zona të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit për legalizimet, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, *konkretisht*.

-Në **4 praktika**, objektet informale janë legalizuar brenda zonës së lirë apo tampon, sipas hartës së zonifikimit të qytetit-muze të Gjirokastrës, përcaktuar në nenin 15, të VKM nr. 832, datë 11.12.2003 “Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit -muze të Gjirokastrës”, i ndryshuar me VKM nr. 345, datë 06.06.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesave në Vendimin nr. 832, datë 11.12.2003 të KM “Për miratimin e Rregullores së Administrimit të Qytetit –Muze të Gjirokastrës, shpallur nga UNESCO-ja “Pasuri e Trashëgimisë Botërore”, pika 5 e nenit 13 dhe neni 14 .

-Në **një rast**, objekti informal është legalizuar në zonë me studim urbanistik,

-Në **15 praktika**, objektet informale nuk kanë ruajtur distancat e lejuara me strukturën e rrugës,

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në të ardhmen të mos legalizohen objektet të cilat nuk plotësojnë dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore të ligjit të legalizimit.

Brenda datës 30.01.2016

5. Gjetje nga auditimi: Në **11 praktika** është evidentuar se **7537.5 m²** sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, konfirmuar kjo me genplane, hartën fushore dhe vektoriale të pronësive paraqitur në autocat (vënë në dispozicion nga drejtoria e ALUIZNI-t, Gjirokastrë), sipërfaqe të cilat janë zvogëluar për efekt mos pagese të vlerës së truallit, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara si

pjesë përbërëse e parcelës ndërtimore të zaptuar, por që janë numërtuar si parcele më vete dhe që të dyja së bashku do të rezultonin sipas sipërfaqes së vetëdeklaruar dhe konstatuar në terren.

Mos konfigurimi i saktë i parcelës ndërtimore, në të cilën evidentohet se nuk janë lënë rrugët hyrëse për në parcelë dhe se parcelat e legalizuar ndodhet në mes të parcelës së madhe, duke i bërë të pashfrytëzueshme pjesët që e rrethojë parcelën e legalizuar, pasi ato nuk mund të shfrytëzohen për vetë pozicionin gjeografik që ato ndodhe.

Vlera e parcelës ndërtimore të palegalizuar paraqitet prej **22,817,868 lekë** (me bono privatizimi vlera 11,408,937 lekë dhe me vlerë leku shumë 11,408,937 lekë), si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit të ish-pronarëve .

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, të marrë masa dhe të ndjek procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit e parcelës ndërtimore, për korrigjimin e kontratave të shitjes së truallit në **11 praktika** me sipërfaqen 7537.5 m², për saktësimin dhe arkëtimin e të ardhurave në vlerën **22,817,868 lekë**.

Brenda datës 28.02.2016

7. Gjetje nga auditimi: Në **10 praktika**, legalizimi i objekteve informale është bërë në kundërshtim me nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, pasi lejet e legalizimit janë dhënë jashtë afatit ligjor, që është nga 2 muaj deri në 3 vjet (*Trajtuar më hollësisht në faqen 21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masat që lejet e legalizimit të cilat plotësojnë kriteret për legalizim, të lëshohen brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në ligj, ose të s’kualifikohen nëse nuk plotësojnë kriteret ligjore, si objekte në kundërshtim me ligjin.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer, ka rezultuar se në disa raste janë evidentuar shkelje të ligjit nr. 9462, datë 03.04.2006 për “Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje ” i ndryshuar, të cilat konsistojnë në:

-Mos plotësimi i aktkualifikimit në të gjitha rubrikat,

-Paraqitja e vetëdeklarimi pa vulën e njësisë vendore, evidentuar kjo në 18 praktika.

-Mungesës së hartës fushore,

-Mos dokumentim i lejeve në sistemin databaze të përgjithshëm,

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, që gjatë procesit të legalizimit të objekteve informale, të ndiqen të gjitha hapat ligjorë të procesit të legalizimit, duke kryer me përgjegjësi procedurat e caktuara për dokumentimin e procesit të legalizimit.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer të dokumentacionit mbi llogaritjen e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore të objekteve informale, rezulton se kjo vlerë për sipërfaqet mbi 3 fish të bazës së objektit informal me funksion banimi, nuk është llogaritur sipas VKM nr. 488, datë 22.07.2014 “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës” dhe urdhrin nr. 664, datë 08.08.2014 “Për miratimin e modelit të formularit të pagesës së parcelës ndërtimore dhe procedurës së plotësimit dhe ruajtjes së tij”, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, me modelet e miratuara të formularëve të pagesave, përcjellë me shkresën nr. 4444, datë 12.08.2014, **duke rënduar padrejtësisht poseduesin për vlerën e parcelës ndërtimore**.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë (Sektori i Financës) të marrë masa, që për praktikën ku vlera e tarifës së parcelës ndërtimore nuk është llogaritur në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t nr. 664, datë 08.08.2014 “Për miratimin e modelit të formularit të pagesës së parcelës ndërtimore dhe procedurës së plotësimit dhe ruajtjes së tij”, me modelin e miratuar të formularëve të pagesave (*përcjellë me shkresën nr. 4444, datë 12.08.2014*), **rikthimin e vlerave të arkëtuara padrejtësisht personave privat, që i kanë paguar ato sipas përlllogaritjeve që do të kryhen**.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 për “Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), ***të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit***, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **179 raste në vlerën 11,322,667 lekë**.

Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në shpenzimet e kryera në favor të kreditorit përfitues “Albtelekom SHA”, likuidim fatura tatimore, u konstatua se janë paguar kamatë-vonesa në vlerën 12,042 lekë, të cilat përbëjnë dëm ekonomik për buxhetin e Drejtorisë së ALUIZNI-it Gjirokastrë

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë, të marrë masa në arkëtimin e vlerës **12,042 lekë**, ndaj 4 ish-punonjësve dhe punonjësve.

Brenda datës 31.01.2016

1.2. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën **7,740 lekë** nga personat përgjegjës.

Brenda datës 31.01.2016

2. Gjetje nga auditimi: Janë llogaritur dhe paguar gjoba dhe interesa për likuidimet e prapambetura të pagesave për *Sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe Tatim mbi të ardhurat personale*, të pa mbajtura në kohë, në shumën e përgjithshme 312,112 lekë.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, që nëpërmjet sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të kryejë kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit të kamatëvonesave në vlerën **312,112 lekë**, ndaj ish-punonjësve; z. *D.M me detyrë ish-Drejtor për vlerën 156,056 lekë dhe znj. F.Sh me detyrë ish-Përgj/Finance për vlerën 156,056 lekë*

Brenda datës 31.03.2016

5. Gjetje nga auditimi: Në **11 praktika**, tarifa e parcelës ndërtimore nuk është llogaritur në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke evidentuar një vlerë parcelë ndërtimore të pa llogaritur prej **7,355,260 lekë**, nga e cila; *me bono privatizimi vlera 3,464,800 lekë dhe me lekë vlera prej 3,890,460 lekë*, **si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve**.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë të marrë masa, për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore në **11 praktika** me vlerë **7,355,260 lekë**.

Brenda datës 31.01.2016

6. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se nga poseduesit e objekteve informale të cilët janë pajisur me leje legalizimi, nuk janë llogaritur dhe paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 142 praktika me vlerë **3,584,364 lekë**, veprime në kundërshtim me germën “ç” të nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshimesh me ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Gjirokastrë të marrë masa, për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës të **142 personave me vlerë 3,584,364 lekë**, të cilët nuk kanë bërë të mundur likuidimin e kësaj takse.

Brenda datës 31.01.2016

7. Për të gjithë praktikatat e evidentuara në pikën 6, 7 dhe 8, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, Tiranë, të marrin masa dhe të njoftohet ZVRPP Gjirokastrë dhe ZQRPP, për vendosjen e kufizimit (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit për tu nxjerrë.

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUZIONI-t Tiranë**, që bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e Kontratës së Punës”, për **8 punonjësit** e mëposhtëm:

1. Z. Th.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUZIONI-t Gjirokastrë.

2. Z. R.Gj me detyrë specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

3. Znj. L.B me detyrë specialiste në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, etj.

4. Z. N. Xh me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

5. Znj. B.T me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

6. Z. Ilia Budri me detyrë Specialist në Sektorin e Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht më specifiket janë:*

-Mos azhurnimi i hartës fushore, veprime në kundërshtim me VKM nr. 437, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave”, pika 11, pika 17 germa a,b,c dhe ç (*Trajtuar më hollësisht në faqen 16-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Në 3 raste, objektet informale janë pozicionuar brenda zonës tampon, ku sipas përcaktimeve të hartës së zonifikimit të qytetit-muze të Gjirokastrës, neni 15, i VKM nr. 832, datë 11.12.2003 “Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit -muze të Gjirokastrës”, bashkëshoqëron këtë rregullore. Në këtë zonë, sipas pikës “b” të nenit 5, të VKM nr. 832, datë 11.12.2003 “Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit -muze të Gjirokastrës”, i ndryshuar me VKM nr. 345, datë 06.06.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 832, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së administrimit të qytetit -muze të Gjirokastrës, shpallur nga UNESCO-ja “Pasuri e Trashëgimisë Botërore”, ndërtimet e reja duhet të respektojnë karakterin e ndërtimeve të qytetit muze (volume, mbulesën, ngjyrat, etj.), gjë që nuk rezulton të jetë realizuar nga pronari i ndërtimit pa leje. Nga ana tjetër sipas ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, neni 29 “Qytetet-muze, zonat-muze, qendrat historike, ansamblet-muze, qendrat dhe parqet arkeologjike, janë kategori objektesh në grup që ruhen në terezinë e tyre si komplekse historiko-arkeologjike, monumentale, arkitektonike-urbanistike dhe mjedisore dhe për këtë ndalohen ndërtimet e reja që prekin objektet ekzistuese, me përjashtim të rjetit inxhinierik nëntokësor.

-Në 8 raste, objektet informale të legalizuara nuk kanë ruajtura distancat e lejuar me strukturën e rrugëve të kategorisë së I, II dhe III, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe Planin Rregullues të Bashkisë Gjirokastrë, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 57, datë 20.10.2011 dhe në proces shqyrtimi dhe miratimi në KKT.

-Në 1 (një) rast, objekti informal është legalizuar në zona me studim urbanistik,

- Në 9 raste, kemi parcelizim të parcelës ndërtimore, duke lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcele ndërtimore të zaptuara nga poseduesi dhe konfirmuara me procesverbal konstatimi, ku vlera e tarifës së parcelës ndërtimore të pallogaritur paraqitet **prej 22,682 mijë lekë**, si mungesë të ardhurash në fondin e kompensimit të ish-pronarëve,

-Në 10 raste, tarifa e parcelës ndërtimore të objekteve të legalizuara janë bërë në shkelje të nenit 20, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e

ndërtimeve pa leje", i ndryshuar", duke evidentuar një vlerë parcelë ndërtimore **prej 2,823 mijë lekë**, si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve .

-**Në 2 raste**, nuk janë ndjekur plotësisht procedurat ligjore, si dhe nuk ka pasur bashkëpunim me institucionet e tjera në lidhje me legalizimet e kryera në pronat e Kryegjyshit Botërore Bektashiane, prona këto të njohura me VKKP nr. 154/5 datë 26.09.1996 (Teqenë e Zallit) dhe VKKP nr. 134, datë 13.03.2008 (Teqenë e Shtufit), veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10058, datë 22.01.2009 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të R.SH dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane, për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellat".

-**për kryerjen e pagese të energjisë elektrike** dhe qirasë së ambienteve pa dokumentacion e nevojshëm ligjorë, veprime në kundërshtim me nenet 35, 35, dhe 36, të udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", sipas periudhave.

7. Znj. F.Ç me detyrë specialiste faturash, pranë Sektorit të Legalizimi dhe Planifikimi Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht më specifiket janë;*

Nga Drejtoria Qendrore dhe ajo rajonale e ALUIZNI-t, nuk është kthyer përgjigje sëbashku me planin e masave për fillimin e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH, për arsye se janë brenda afatit ligjor për ti shqyrtuar e filluar zbatimin e rekomandimeve.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Kristaq Gjurgjaj, Hysen Metko dhe Aleksandër Papdimitri, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT